

V E N D I M
Nr. 708, datë 21.12.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.206, DATË 26.3.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRITERET E PJESËMARRJES SË SHTETIT NË PËRBALLIMIN E
DËMEVE, NË RASTE FATKEQËSISH”

Në mbështetje të neneve 100 dhe 108 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.206, datë 26.3.1998, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafet e parë dhe të dhjetë të pikës 3, fjalët “këshilli i rrethit”, zëvendësohen me “këshilli i qarkut”.
2. Në pikën 8.4 dhe në pikën 9, fjala “rreth” zëvendësohet me fjalën “qark”.
3. Në paragrafin e katërt të pikës 3, në paragrafin e parë të pikës 6 dhe në pikat 8.4 dhe 9, fjalët “Sekretariat shtetëtor për pushtetin lokal” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Pushtetit Lokal”.
4. Në paragrafin e parë të pikës 6 dhe në pikën 9, pas fjalëve “Ministria e Punëve Publike...” hiqen fjalët “... dhe Transporte”.
5. Në paragrafin e pestë të pikës 6.b, pas fjalëve “...brenda zonës së zhvillimit me plan rregullues...” hiqen fjalët “...të miratuar nga KRRT-ja e rrethit” dhe shtohen fjalët “...nga organet përgjegjëse”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta